

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju informojmë se:

OSHMA-të TV Jug, TV RE.AL, Tv Skampa nuk depozituan në AMA më datë 22.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë. AMA rikujton këto OSHMA, por dhe të tjera, të njoftuara në mënyrë të përsëritur, me shkresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

Top News 08:01; 08:29

TV Shijak 19:58; 20:40

TV Channel 1 09:53; 10:00; 11:39; 12:28; 13:07; 14:15; 19:48; 20:34

RTV Gjirokastra, 07:48; 07:52; 07:58; 08:32; 08:33; 08:34; 10:05; 10:08; 10:10; 11:25; 11:27; 11:30; 12:57; 12:58; 12:59; 13:45; 13:47.

RE.AL 09:13; 09:14; 09:15; 12:15; 12:17; 12:18; 12:19; 12:21; 14:53; 14:55; 14:56; 14:57; 18:04; 19:35

Antena Nord 18:25; 19:00; 19:20; 19:50

TV ALPO 12:55; 13:00; 13:05; 13:10; 13:15; 13:20; 13:25; 13:30; 13:35

Ka transmetuar reklamë të paidentifikuar:

RTV Gjirokastra, 15:26; 23:08

Kanë transmetuar reklama politike brenda edicionit të lajmeve OSHMA-të:

TV Klan News 17:31; 21:15; 21:30; 21:51; 22:36; 22:51; 23:10; 23:17

TV Channel 1 15:11; 18:11; 20:11; 22:41

Në transmetimet e datës 21.04.2021 (prej orës 08:00 – 24:00) OSHMA TV Channel 1 ka vendosur logon e një subjekti politik shoqëruar me fjalë për të votuar pro tij në zgjedhjet e 25 prillit. OSHMA-ja duhet ta ndërpresë një praktikë të tillë të reklamës politike dhe të respektojë kërkesat e Kodit Zgjedhor.

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet nga monitorimi për transmetimet e datës 21.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 22.04.2021